

VENDIM
Nr.42, datë 18.12.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Gjergj Sauli	anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 15.10.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.46 Akti që i përket:

KËRKUES: Fatmir Çupi, përfaqësuar nga avokat Seit Zeqiri, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Bujar Sheshi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.52, datë 7.10.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.59, datë 29.12.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr.673, datë 15.11.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara për një proces të parregullt ligjor, duke pretenduar se gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit janë cenuar standardet e tij në këto drejtime:

- Avokati mbrojtës nuk është njohur me të gjitha materialet e çështjes nga ana e akuzës, para se çështja të kalonte për gjykim dhe, ai vetë nuk është njohur me kërkesën për gjykimin e çështjes dërguar gjykatës;

- Nga ana e policisë gjyqësore është pyetur gjatë fazës së hetimit pa praninë e mbrojtësit ligjor, duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes me avokat;

- Palët nuk janë vënë në kushte të barabarta, sepse gjykata nuk ka pranuar të thërrasë të gjithë dëshmitarët e kërkuar nga mbrojtësi i kërkuesit dhe është bazuar mbi prova të marra në mënyrë të kundërligjshme;

- Gjykata ka zbatuar gabim ligjin penal material, lidhur me cilësimin ligjor të veprës penale si dhe ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme te provat e administruara.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fehmi Abdiun, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.52, datë 7.10.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkuesi është deklaruar fajtor për “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim, si dhe për veprën penale “armëmbajtje pa leje” dhe është dënuar me 25 vjet burg.

Me vendimin nr.59, datë 29.12.2005 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, mbi ankimin e tij, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe e ka dënuar kërkuesin me 22 vjet burg.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me deklarimin fajtor të kërkuesit dhe e ka dënuar përfundimisht me 20 vjet burg.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e kërkuesit për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore të sipërcituara janë përqendruar në disa nga elementet e procesit të rregullt ligjor, duke iu referuar neneve 31 shkronjat “a”, “ç”, “d” të nenit 42/1 të Kushtetutës nenit 6/3 shkronjat “a”, “c” dhe “d” të Konventës, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Në kuptimin doktrinar ato kanë të bëjnë me standarde kushtetuese, por për të

arritur në një përfundim sa më të drejtë duhet të ballafaqohen me faktet e dosjes hetimore dhe gjyqësore. Veç kësaj, duhet të analizohen në lidhje me të drejtat e siguruara nga Kushtetuta.

Sipas nenit 31 shkronjat “a”, “ç” dhe “d” të Kushtetutës, “kushdo gjatë procesit penal ka të drejtë të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet për të drejtat e tij...”, “ të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij...”, si dhe “... të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve”. Këto kërkesa kanë lidhje me të drejtën për informim, të drejtën e mbrojtjes, me mënyrën e marrjes së provave dhe ndikimit që ato kanë pasur në ecurinë e procesit gjyqësor.

Në nenin 50 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet: “Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njej të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit”. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite është i pandehuri, i cili përcakton, gjithnjë në kuadër të kërkesave ligjore, kufijtë e të drejtave të mbrojtësit të tij.

Në kërkesën në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se në prokurën nr.4542 Rep., nr.372 Kol. të datës 13.9.2004 avokatit i janë dhënë tagra përfaqësimi për kryerjen e çdo lloj veprimi që atij ia lejon ligji, njësoj sikur të ishte i përfaqësuar. Në këtë rast, veprimet juridike të kryera nga mbrojtësi ligjor, brenda tagrave që i janë dhënë, krijojnë pasoja të drejtpërdrejta për kërkuesin.

Kërkuesi pretendon se nuk është njohur me materialet e çështjes në përfundim të hetimeve, para se çështja të kalonte për gjykim, si dhe me kërkesën për gjykim, duke iu mohuar kështu e drejta për t’u informuar.

Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në dosjen gjyqësore gjendet procesverbali i njohjes me aktet i datës 27.10.2004, i firmosur nga mbrojtësi i kërkuesit. Në këtë procesverbal citohet: “I pandehuri dhe mbrojtësi u njohën me të gjitha aktet e çështjes penale nr.184 të vitit 2004.....Gjatë njohjes së të pandehurit dhe avokatit të tij nuk u paraqit ndonjë vërejtje në ecurinë e veprimeve hetimore dhe nuk kishte ndonjë pretendim për kryerjen e këtyre veprimeve”.

Edhe më pas veprimet e prokurorisë kanë qenë konform nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, prokurori pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që mbrojtësi ose i pandehuri është njohur me to, vendos dërgimin e çështjes në gjykatë.

Prokurori, pasi mbrojtësi i kërkuesit është njohur me aktet, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim. Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa për gjykim e datës 2.11.2004 e ndodhur në dosjen gjyqësore, është firmosur nga avokati i kërkuesit. Ai, si mbrojtësi i kërkuesit, përsa kohë ka qenë i pajisur me një prokurë, me të cilën kërkuesi i kishte dhënë të drejtën e përfaqësimit për çdo lloj veprimi që ia lejon ligji, nuk ka pasur asnjë pengesë për t’u njohur edhe me kërkesën për gjykimin e çështjes. Sipas nenit 31/a të Kushtetutës vënia në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet individit është një e drejtë ngushtësisht personale, por sipas nenit 31/ç individit ka të drejtë të mbrohet me ndihmën e një mbrojtësi ligjor. Veprimtaria e tij (mbrojtja) nuk përfshin vetëm përfaqësimin në gjyq të të pandehurit, por dhe çdo lloj komunikimi të organit të akuzës me mbrojtësin për llogari të të pandehurit, siç është dhe kërkesa për gjykim.¹

Gjykata Kushtetuese konstaton se nga ana e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij nuk ka pasur asnjë kërkesë paraprake para fillimit të shqyrtimit gjyqësor para gjykatës për të kundërshtuar vlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, mundësi kjo që jepet nga neni 129/2 i Kodit të Procedurës Penale. Veç kësaj, kontrolli kushtetues për një proces të rregullt ligjor, nënkupton edhe konsumimin, si rregull, para gjykatave të sistemit gjyqësor, të çdo pretendimi ligjor që parashikohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese.² Prandaj, pretendimet e ngritura nga kërkuesi edhe për këtë arsye nuk mund të shërbejnë si shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Pretendimi tjetër i kërkuesit, lidhet me të drejtën e mbrojtjes me avokat, një e drejtë kjo e sanksionuar në nenin 31/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 6 të Konventës

¹ Ligji nr.9109, datë 17.7.2003, Fletorja Zyrtare 66/2003 “Për profesionin e avokatisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, ku përcaktohet: “Avokati, në funksion të ushtrimit të profesionit të tij, ka të drejtë të kërkojë nga institucionet e administratës publike, në përputhje me ligjin, shpjegime, të dhëna dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij. Institucionet e administratës publike, sipas kompetencës dhe procedurave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, janë të detyruara të përmbushin kërkesat e avokatit”.

² Vendimet nr.9 dhe nr.10, datë 9.5.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përmbledhje vendimesh 2005, faqe 108, 115, vendimi nr.1, datë 16.1.2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përmbledhje vendimesh 2006, faqe 13.

Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe e pranuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Po sipas kërkesës, janë kryer veprime hetimore në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 296/1 të Kodit të Procedurës Penale, sepse ai është pyetur pa praninë e mbrojtësit. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në lidhje me këtë pretendim del e nevojshme para së gjithash për të parë e analizuar përmbajtjen e dispozitave konkrete të Kodit të Procedurës Penale, që bëjnë fjalë për këtë problem.

Sipas nenit 49/1 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë. Ndërkohë, sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale dispozitat që zbatohen për të pandehurin, zbatohen dhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve, kur ky kod parashikon ndryshe. Ndaj këtij personi shtrihen dhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin.

Neni 296/1 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton: *“Oficerët e Policisë Gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, me praninë e detyrueshme të mbrojtësit”*.

Duke analizuar dhe çmuar së bashku nenet 49/1 dhe 296/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese vlerëson se qëllimi i dispozitës është garantimi i mbrojtjes së detyrueshme, nëse e kërkon personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Por ky detyrim për garantimin e mbrojtjes së palës së akuzuar nuk është kategorik, nëse personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet nuk e kërkon atë. Në të kundërt, nëse ai e kërkon, pala akuzuese duhet t’ia sigurojë mbrojtjen konform urdhërimeve të nenit 296/1 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, kjo e drejtë nuk barazohet me mbrojtjen e detyrueshme, pasi nga ajo mund të hiqet dorë nga personi me vullnet të lirë.

Pikërisht kjo ka ndodhur edhe në lidhje me kërkesën e kërkesës. Siç rezulton nga procesverbali i datës 27.6.2004, kërkuesi gjatë marrjes në pyetje në prokurori është informuar se ka të drejtën e pranisë së një mbrojtësi dhe ai është përgjigjur: *“unë nuk kam mbrojtës ligjor. Përsa i përket pyetjes që ju bëni, unë e kuptoj dhe deklaroj se jam dakord të jap shpjegime”*. Në rastin konkret, kërkuesi në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, ka shprehur dëshirën të përgjigjet dhe pa praninë e një mbrojtësi, duke mos dashur të përfitojë nga kjo e drejtë kushtetuese dhe ligjore e tij.

Pretendimi tjetër i kërkesës se është deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, si rezultat i dhunimit fizik dhe psikologjik të dy dëshmitarëve të mitur, nga punonjës të policisë gjatë hetimeve paraprake, rezulton gjithashtu i pabazuar. Sipas tij, provat vendimtare mbi të cilat është bazuar gjykata për shpalljen e tij fajtor kanë qenë deklaratat nga ana e këtyre dy dëshmitarëve të mitur.

Gjykata Kushtetuese e sheh të arsyeshme të ndalet te mënyra e marrjes së provave, si një element i rëndësishëm kushtetues i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Kjo Gjykatë, lidhur me këtë problem është shprehur se *“...vlerësimi i provave, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor”*.³

Në lidhje me pretendimin, se dëshmitarët e mitur janë dhunuar fizikisht gjatë marrjes në pyetje, kërkuesi nuk ka paraqitur prova që ta vërtetonte atë.

Nga dosja gjyqësore nuk rezulton që të jetë pretenduar nga dëshmitarët se punonjësit e policisë kanë përdorur, ndaj tyre, dhunë psikologjike dhe fizike.

Për më tepër, nga dosja gjyqësore konstatohet se procesverbalet e datës 14.7.2004 janë mbajtur konform neneve 297, 155-158 të Kodit të Procedurës Penale, pasi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Gj.Z., ka qenë i pranishëm babai i tij, ndërsa në rastin e dëshmitarit F.Z., mësuesi i tij, veprime këto që janë në përputhje me nenin 361/5 të Kodit të Procedurës Penale. Deklarimet e këtyre dëshmitarëve janë vlerësuar dhe në seancë gjyqësore nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në përputhje me nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit, gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe vlerësohen në seancë gjyqësore.

Në lidhje me rëndësinë e thënieve të tyre, Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj është shprehur: *“nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, si dhe evidentimin e*

³ Vendimi nr.1, datë 12.1.2007 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

pavlefshmërisë së një dëshmie të marrë gjatë hetimeve paraprake, përse kohë që gjykatat e zakonshme në arsyetimin e vendimeve të tyre e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera”.⁴

Në lidhje me pretendimin se gjykata nuk ka pranuar thirrjen dhe pyetjen e disa dëshmitarëve të kërkuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, duke u shkelur parimi i barazisë së armëve, Gjykata Kushtetuese konstaton se ky problem vlerësohet sipas natyrës së çështjes. Në rastin konkret, nuk është provuar që gjykata të ketë prekur parimin e barazisë së armëve. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar dhe pyetur dy dëshmitarë të kërkuar nga mbrojtja. Gjykata Kushtetuese, duke mbajtur një qëndrim të caktuar në lidhje me këtë problem, ka pranuar se gjykata nuk është e detyruar të pranojë apriori kërkesën e të pandehurit, por pasi të ketë dëgjuar pretendimet e palëve duhet t’i japë përgjigje atyre me vendim.”⁵

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë, prandaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: V.Kristo.

Anëtarë: K.Peçi, Gj.Sauli, P.Plloçi, Xh.Zaganjori, K.Puto, F.Abdiu, S.Sadushi, S.Berberi.

⁴ Vendimi nr.9, datë 28.4.2004 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përmbledhje vendimesh viti 2004, faqe 68.

⁵ Vendimi nr.90, datë 25.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përmbledhje vendimesh viti 2001, faqe 253.